



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 200/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Gračanic paraqitur kundër subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS), dega në Gračanic, për shkak të vendosjes se posterëve në hapësirat private, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.10.2013, nga subjekti politik SLS dega në Gračanic, me të cilën pretendohet se më 07 dhe 08 Tetor 2013 persona të panjohur kanë ngjitur posterat e subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS) në dyert të zyrës së partisë Samostalna Liberalna Stranka (SLS) në fshatin Dobratin.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik Savez Kosovskih Srba, (SKS) në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 09.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.10.2013, në ora 16:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Savez Kosovskih Srba (SKS) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik SKS mohon pretendimet e ankuesit dhe ku thekson se SKS-ja nuk është e ndërlidhur fare me pretendimet e përmendura në ankesë ashtu siç theksohet në ankesën e SLS, pasi që për këtë çështje janë të panjohur personat dhe se në fotografit shihen vetëm posterat e vendosur dhe asgjë tjetër prandaj aktivistet e SKS-së nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë ngjarje dhe se këto pretendime i konsiderojnë si provokim dhe se këta poster të cilët janë vendosur në dyert të SLS-së janë hequr nga ndonjë vend tjetër dhe gjithë kjo vepër ti përshkruhet SKS-së. Andaj me këtë rast SKS-ja ka propozuar që rastin të lajmërohet në polici për zbulimin e kryerësit të vërtetë të kësaj vepre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, ka konstatuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse pasi objekti për të cilin pretendohet nga pala ankuese se është selia e SLS-se nuk mund të identifikohet për asnjë moment me asnjë shenje identifikuese ashtu siç pretendohet. Andaj PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 200/2013 më datën 17.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*